

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

From: [REDACTED]@aksk.gov.al -- [REDACTED]
Sent: Thursday, March 20, 2025 10:11
To: info@idp.al
Cc: [REDACTED]
Subject: Kerkese për opinion ligjor

Follow Up Flag: Follow up
Flag Status: Completed

I nderuar z. Dervishi,

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 15, datë 06/03/2025 "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës online Tik Tok, si dhe Urdhrit të Përbashkët Nr 89, datë 07/03/2025 midis AKSK dhe AKEP "Për miratimin e masave teknike dhe procedurale për realizime e ndërprerjes së përkohshme të aksesit në platformën Tik Tok dhe detyrim e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike për zbatimin e tyre, AKSK ka nisur punën për implementimin e hapave të nevojshme për bllokimin e aksesit në platformën Tik Tok, në Republikën e Shqipërisë".

Për sa më sipër, si pjesë e masave teknike, do të kryhet edhe implementimi i platformës DPI (Deep Package Inspection) pranë operatorëve të komunikimeve elektronike.

Kjo platformë do të bëjë të mundur analizimin e trafikut me qëllim identifikimin e paketave të Tik-Tok, për të kryer mbylljen e tyre.


Theksojmë se analizimi i këtyre paketave do të bëhet vetëm në platformën DPI e cila është e instaluar në ambientet e operatorëve të shërbimit dhe asnjë nga informacionet e perpunuara për këtë analizë, si psh: adresat private IP, si dhe signaturat e paketave, nuk do të transmetohet jashtë këtij ambjenti.

Gjithashtu si pjesë e zgjidhjes teknike pranë Autoritetit rregullator AKEP do të implementohet Qendra e Kontrollit e cila do të jetë e lidhur nëpërmjet një Tunnel VPN LAYER2 me platformën e instaluar pranë operatorit.

Roli qendrës së kontrollit do të jetë si më poshtë :

- a. Përcaktimin dhe rifreskimin e rregullave për ekzekutimin e komandave automatike brenda platformes DPI për bllokimin e paketave me permbajtje Tik Tok (mbi portat 80/443/161/162). Këto rregulla përgjithësisht përcaktohen herën e parë dhe vetëm në raste të vecanta mund të ndryshojnë, duke ruajtur gjithmone transparencën me operatorët e shërbimeve të internetit.
- b. Përdorimin e protokollit snmp v3 auth-priv për të dërguar mesazhe njoftimit të nivelit alert nga operatori i shërbimit drejt qendrës së kontrollit, për rastet :
 1. Djegie e Hard Disk Drive
 2. Bllokim i konfigurimit të Hardisqeve
 3. Rritje e kapacitetit të ruajtjes së informacionit (storage)
 4. Rritje e kapacitetit të trafikut
 5. Rritje e ngarkesës së CPU-se (CPU Overloading)
 6. Rritje e hapsirës në memorjen dinamike RAM
 7. Probleme fizike të rrjetit (psh, këputje e kabllit)
 8. Ndërprerje e energjisë
 9. Dështim i Bllokut të ushqimit
- c. Gjenerim i informacionit për sitet me të vizituar dhe adresat publike IP (Mbi portat 80 dhe 443)
- d. Marrjen e Raportit për Bandëidthin e gjeneruar për çdo operator (Mbi portat 80 dhe 443)
- e. Rifreskimi i signaturave të Tik Tok, i cili normalisht do të kryhet sipas rastit dhe nevojës sipas procedurës së mëposhtme:

Signaturat e rifreskuara do të merren nëpërmjet vendorit përmes një lidhje të sigurve VPN drejt një ambjenti të izoluar llogjikisht (mikrosegmentuar) në qendrën e kontrollit të autoritetit rregullator. Signaturat pasi të testohen në ambjent laboratorik të qendrës së kontrollit nga eksperti i trajnuar i Autoritetit Rregullator, do të dërgohen drejt kompanive të ofrimit të internetit për tu rifreskuar përmes lidhjes tunel të sigurtë VPN L2TP. Theksojme se ambjenti i laboratorik në Autoritetin Rregullator ku ngarkohen signaturat e reja të Tik Tok nga vendori, do të jetë tërësisht i izoluar dhe nuk do të ketë asnjë mundësi aksesimi me ambjentin « Production », të lidhur drejtëpërdrejtë me kompanitë e ofrimit të internetit. Frekuenca e ngarkimit të signaturave do të jete rast pas rasti, menjëherë pas nxjerrjes nga platforma Tik Tok të signaturave të reja.



Për sa më sipër, kërkojmë opinionin tuaj, nëse informacioni që transmetohet midis Operatorëve dhe Qendrës së Kontrollit, përmes tunelit të enkriptuar, konsiderohen si të dhëna personale sipas ligjit nr 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt.



IGLI TAFI

General Director & National Cyber Coordinator
National Cyber Security Authority

Kdimdp Komisioneri

From: Kdimdp Komisioneri <kdimdp.komisioneri@idp.al>
Sent: Thursday, March 20, 2025 3:05 PM
To: [REDACTED]@aksk.gov.al'
Subject: Kthim pergjigje kerkeses per opinion ligjor

Përschendetje Z. Tafaj,

Në përgjigje të kërkesës suaj për opinion nëse informacioni që transmetohet midis Operatorëve dhe Qendrës së Kontrollit, përmes tunelit të enkriptuar, konsiderohen si të dhëna personale sipas ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim, "*Ligji*"), më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit si vijon.

Referuar informacionit të parashtruar nga ana juaj rezulton se, për bllokimin e aksesit të subjekteve të dhënave në platformën TikTok në Republikën e Shqipërisë do të përdoren dy komponentë teknikë kryesorë:

- *Platforma DPI (Deep Packet Inspection)* që do të instalohet pranë operatorëve të internetit;
- *Qendra e Kontrollit pranë AKEP*, të cilat do të jenë të lidhura nëpërmjet një Tunnel VPN LAYER2 me platformën e instaluar pranë secilit operator, për të mbikëqyrur implementimin e rregullave të bllokimit.

Sipas Ligjit, nen 5, pika 3, "*E dhënë personale*" është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash, pika 16 "*Përpunim*" është çdo veprim ose një grup veprimesh, që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi dhe pika 24 "*Subjekt i të dhënave*" është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm. Nderkohë, një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një apo disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, *një identifikues në internet*, ose një apo më shumë faktorëve specifikë, lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror;

Të dhënat që do të përpunohen nga Qendra e Kontrollit janë, adresat publike të IP, lista e faqeve të vizituara, Signaturat e paketave të platformës TikTok, si dhe Raportet për Bandëidhtin e gjeneruar për çdo operator (mbi portat 80 dhe 443).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në informacionin që do të transmetohet midis Operatorëve dhe Qendrës së Kontrollit duke përdorur Tunelin Virtual Private Netëork (VPN) të enkriptuar, disa elementë mund të përmbajnë përpunim të të dhënave personale. Konkretisht, nëse në procesin e monitorimit dhe raportimit për trafikun mbi portat 80 dhe 443 përfshihen IP-të publike të subjekteve të të dhënave, atëherë ato mund të konsiderohen si të dhëna personale për aq sa janë të lidhura me një subjekt të identifikueshëm.

Nëse një adresë IP publike e caktuar nga një ISP që përdoret nga shumë subjekte të të dhënash të ndryshëm përmes përdorimit të NAT (Network Address Translation) ose CGNAT (Carrier-Grade NAT), atëherë ajo nuk mund të konsiderohet një e dhënë personale, për aq sa nuk ka elementë të tjerë shoqërues teknik që e lidhin me subjektin e të dhënave.

Lidhur me gjenerimin e informacionit për sitet më të vizituara dhe adresat publike IP, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nëse ky informacion i grumbulluar nuk mund të lidhet me subjektet e të dhënave të veçantë, atëherë nuk është e dhënë personale. Megjithatë, nëse këto informacione janë të ndërlidhura me IP-të publike

të subjekteve të të dhënave specifike, atëherë mund të konsiderohen si të dhëna personale, si dhe mund të çojnë në profilizimin e përdoruesve, veçanërisht nëse kombinohen me adresat IP.

Përdorimi i protokollit snmp v3 auth-priv për të dërguar mesazhe njoftimit të nivelit alert nga operatori i shërbimit drejt qendrës së kontrollit, nuk konsiderohen të dhëna personale për sa kohë lidhen vetëm me statusin e infrastrukturës teknike dhe jo me individë specifike.

Sa i takon përdorimit të Signaturave të TikTok që do të merren nëpërmjet vendorit përmes një lidhje të sigurtë VPN drejt një ambienti të izoluar llogjistikisht (mikrosegmentuar) në Qendrën e Kontrollit të autoritetit rregullator Zyra e Komisionerit vlerëson se, nëse signatura është një hash teknik apo ekuivalent dhe që nuk lidhet me një subjekt të të dhënave të identifikueshëm, atëherë nuk kemi të bëjmë me përpunim të të dhënave personale në kuptimin të ligjit. Nëse signatura përmban identifikues unike të pajisjes, përdoruesit ose llogarisë, ajo mund të përdoret për të identifikuar një subjekt të të dhënave ose për të monitoruar aktivitetin e tij në platformë, duke u konsideruar kështu si të dhëna personale.

Për vlerësimin e mësipërm Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë dhe vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (CJEU) në çështjen C-582/14, Breyer vs Germany që ka të bëjë me përdorimin e adresave IP si të dhëna personale dhe mënyrën se si ato mund të përdoren për identifikimin e përdoruesve.

Në përfundim, vlerësimi përfundimtar i takon çdo Operatori, që në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave, pas verifikimit të bazës ligjore konkrete, si dhe legjislacioneve të tjera detyruese (nëse ka) mund të legjitimojnë këtë proces përpunues të të dhënave personale.


Megjithatë, Zyra e Komisionerit vlerëson duke u bazuar në informacionin e referuar nga ana juaj, ndërmarrja e hapave teknik nga ana e operatorëve dhe AKEP nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 124/2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik Dervishi

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

www.idp.al



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER

Informacioni i transmetuar në këtë mesazh ka përmbajtje konfidenciale. Është i ndaluar printimi apo shpërndarja nga persona dhe subjekte të ndryshëm prej marrësit të destinuar të këtij mesazhi. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, fshini nga kompjuteri juaj çdo material lidhur me të.

